

numër 9
dhjetor 2016

toka

IME

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



**MAKINA PËR MBULIMIN DHE
VENDOSJEN E FOLIVE PLASTIKE**




Si u reflektua viti 2016 në sektorin bujqësor në rajon

**Kultivimi i
kungullit
muskant**



**Prodhime
alternative
prej molle**



Agroxhel

**Barëra kundër
barërave
të këqija**






**Bashkimi Evropian
REFORMA TË
POLITIKËS BUJQËSORE
TË PËRBASHKËT
EVROPIANE**

4

**Nga fara te filizi:
SI TË PËRZGJIDHNI
FARË TË MIRË**



6



**MASA PËR
MBROJTJE NGA
PËRMBYTJET**

18

**Aktivitetet:
RRETHET E STUDIMIT,
METODË E SUKSESSHME
PËR EDUKIMIN E
FERMERËVE**



26



**Aktivitetet IKC:
KONFERENCA RAJONALE
BUJQËSORE ME
MODERATORË MBI
PROBLEMET BUJQËSORE
PËR 2016**

30



FEDERATA E FERMERËVE NË R.M.

Adresa: rr. Hristo Smirnenski nr.15 1000 Shkup
Tel:389 02 3099 044, Faks:389 02 3099 044
e-mail: ffrm@ffrm.org.mk
uebfaqe:www.ffrm.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjja e Re, Pukë
Tel.+355 212 2 2412. Mob.:+355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agro-puka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY

Adresa: rr. Gjon Serreçi, p.n, Ferizaj, Kosovë
Tel: 038742190, Mob:+377 (0)44 368 356
Faks: 038742190
e-mail:main@ngoikc.org
uebfaqe:www.ngoikc.org



WeEffect – Qendra Suedeze për Kooperativa, punon me organizatat partnere në mbi 10 vende, me vizion të botës së qëndrueshme dhe të drejtë të çliruar nga varfëria. WeEffect e mbështet revistën rajonale "Toka Ime" me qëllim që të zhvillohet lëvizja e bujqve në Ballkan dhe të përfordhet zëri i përbashkët i bujqve.

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FFRM, AGRINET, AGROPUKA, IKC për Shqipëri-në, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit të suazat e sektorit bujqësor.



**FEDERATA E FERMERËVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Toka ime, dhjetor 2016

Botues: FFRM

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Gigo Mihajlovski, nr. 4-1/1,
1000 Shkup

Udhëheqës: Bllagoçe Najdovski

Tel/faks: 02 3099042
e-mail: mojazemja@gmail.com

Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska

Botuar më:
dhjetor 2016

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska

Gazetar: Monika Risteska

Bashkëpunëtorë profesionale

Dr. Vitor Malutaj, Tomi Pikuli, Nikolin Karapanci, Sabah Djaloshi, Doruntina Kurteshi, Ekrem Bajrami, Rade Karanfilovski, Dr. Dragi Tanevski, Ilir Gashi, Besmira Alia, Ivan Shulog, Prof. dr. Gordana Pop Simonova, Stevan Orozovic, Dipl. agr. Dimitar Arnaudov, Dipl. agr. Vanko Zahariev, Docent. dr. Mile Markoski, Prof. dr. Tatjana Mitkova, Prof. dr. Ivan Blinkov, Eljona Meleg

Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]

PËRKUSHTIMI

“Që të arrish diçka, duhet t’i kushtosh pjesën më të madhe të kohës së vet. Ne, bujqit, pjesën më të madhe të kohës së vet ia dedikojmë truallit tonë pjellor në bujqësi.” Këtë ma tha një fermer me përvojë nga fshati Gabrovo. Prej atëherë, gjithmonë kur udhëtoj nëpër shtet e vështroj natyrën tonë të mrekullueshme, mendoj për atë që ne i kushtojmë më tepër kohë. Ja konkretisht, unë si gazetar dhe komunikolog, më tepër kohë i përkushtoj bisedimit dhe shkrimit. Dhe tani bëj pyetjen: sa kohë më plotëson mua kur flas dhe shkruaj. T’ju them sinjerisht – shumë. Nëse nuk e bëj këtë, nuk e di se çfarë do të bëja dhe çfarë do të punoja. Gjithashtu bëj pyetjen: Sa janë të lumtur bujqit tanë me kohën e vet të përkushtuar. Këtu nuk e di se çfarë të them, sepse këtë e dinë ata.

Por, sinjerisht mendoj se jemi krenarë që janë fermerë, kurse pesimistë dhe të dëshpëruar prej problemeve të mbledhura, sidomos me blerjen, lëvizjet drastike të çmimeve, ndryshimet klimatike, “kuptimi dhe dëgjimi” i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare.

Unë vetëm do të thosha se duhet të jeni krenarë që jeni fuqi lëvizëse në këtë rajonin tonë të vogël dhe problematik sepse nëse nuk jeni ju, atëherë nuk do të kemi ushqim, eksporti do të zvogëlohet dhe do ta humbim tërësisht traditën tonë të cilën e kultivoni ju.

Në fund ky vit ishte i mbushur me sfida në bujqësi, ju propozoj të punoni mandej në bashkimin tuaj dhe investimin në metoda dhe teknologji të reja të prodhimit dhe vëmendje të veçantë i përkushtojmë bashkimit rajonal.

Në emër të redaksisë dhe bashkëpunëtorëve të revistës “Toka ime” ju uroj që viti 2017 të jetë një vit i begatë dhe i suksesshëm.



Me respekt,
Biljana Petrovska-Mitrevska
Redaktore e revistës „Toka Ime”

Ju dëshirojmë vit të begatshëm dhe suksese në Vitin e Ri!



2017

FEDERATA E FERMERËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Reforma të Politikës Bujqësore të Përbashkët Evropiane

Shkruan: Stevan Orozovich

Komisioni Evropian deri në fund të vitit 2017 do të miratojë komunikim për të ardhmen e politikës së përbashkët Evropiane (Communication on the future of the Common Agricultural Policy - CAP) njoftoi Presidenti i Komisionit Evropian Zheha-Klod Junker. Në hapjen e konferencës vjetore të bujqësisë në Bruksel, ku Junker njoftoi: Thjeshtëzimi dhe modernizimi do të jenë fjalët kyçe dhe qëllimi kryesor i komunikimit për të ardhmen e politikës së përbashkët bujqësore, të cilin komisioni planifikon ta miratojë deri në fund të vitit 2017. Hapi i parë do të jetë dëgjimi publik që do të fillojë në fillim të vitit 2017, ku do tu mundësohet të marrin pjesë të gjitha palëve të interesuara në diskutimin për drejtimin e kësaj politike të rëndësishme strategjike për BE-në.

Para 400 delegatëve Komisionari Evropian për Bujqësi Fil Hogan vuri në dukje se politika e përbashkët evropiane duhet të garantojë disa rregulla bazë me të cilat do të sigurojë fleksibilitet më të madh në treg, prodhim më të qëndrueshëm bujqësor dhe zëvendësimin më të mirë të gjeneratave të reja.

Rrënjët e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) qëndrojnë në Ev-

ropën e pasluftës, ku ato ishin pjesë e planit të madh për të sjellë zhvillim gradual në çdo aspekt të mundshëm të aktivitetit social dhe ekonomik dhe për të parandaluar konfliktet e ardhshme. Ajo u krijua me një qëllim të qartë: për t'i ndihmuar fermerët e BE-së të bëhen fitimprurës dhe të qëndrojnë të tillë. Një aspekt kyç ishte që të rritet furnizimi me ushqime, bazuar në parimin se kontinenti do të duhet të ecë drejt një zone të madhe të tregut, tek e cila do të jenë të harmonizuara produktet bujqësore dhe ushqimore.

Për t'u arritur kjo, nevojitet politikë e përbashkët që bujqësia të bëhet aktivitet i drejtë midis të gjitha shteteve anëtare. Kjo paraqet një aktivitet të vështirë, pa dyshim që reflekton në reformat e njëpasnjëshme tani më të kryera të PPB-së. Institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare janë duke u përpjekur vazhdimisht që ta përmirësojnë politikën dhe ta përshtatin me tregjet dhe me vetë shoqërinë që është duke ndryshuar.

Në gjysmë të programit 201-2020, në BE tashmë ka filluar të flitet për reforma dhe financime të tjera që do të jenë më të lidhura me çështje si qëndrueshmëria dhe ngjashëm.

FERMERI "AKTIV"

Një nga tregimet më të zakonshme në debatin për CAP të tanishëm është përkufizimi për "fermer aktiv", i cili në masë të gjerë dikton kriteret se për sa fonde ka të drejtë një fermer.

Shpërndarja e mjeteve midis profesionistëve bujqësorë ishte një nga objektivat kryesorë të ministrave të bujqësisë të BE-së, por sektori i bujqësisë spanjolle nuk mendon se kjo është arritur.

Hose Luis Migel, nga asociacioni i bujqësisë spanjolle COAG, dyshon nëse Komisioni Evropian është duke bërë gjithçka që mundet për të përcaktuar në mënyrë të qartë konceptin e "fermerit aktiv".

Migel insiston se ligjet aktuale nuk arrijnë të "legjitimojnë" atë se çfarë duhet të jetë "shtylla e reformës" në kuptimin të modelit të konsoliduar të prodhimit të ushqimit, faktorëve social dhe qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor.


Ai shtoi se CAP-i aktual "vazhdon të injorojë" natyrën strategjike të sektorit dhe i bëri thirrje Brukselit që të dalë me politikat për mbrojtjen e sektorit dhe "ruajtjen e fshatit të gjallë."



Sekretari i Lidhjes së Fermerëve të vegjël (UPA), Ignasio Senovilla, paralajmëroi se sistemi i regjionalizimit nuk duhet të adresohet drejt çfarëdo lloji të reformave të ardhshme, me qëllim që të shmanget çdo paqëndrueshmëri në shpërndarjen e fondeve.

Një nga "problemet" kryesore që u paraqitën me reformat e njëpasnjëshme është se kanë ndryshuar kriteret që e bëjnë të vështirë të koordinohet me programet për financim.

Një nga fushat më të rëndësishme të veprimtarisë së institucioneve të BE-së, si në aspektin e përfshirjes të të drejtave të përbashkëta të fituara ashtu si dhe në drejtim të pjesës së buxhetit të brendshëm të BE-së paraqet POLITIKËN E PËRBASHKËT BUJQËSORE (PPB), e cila daton nga viti 1960, kur është vendosur në mënyrë që ta ruajë prodhimin bujqësor, ka siguruar qasshmërinë e stoqeve me çmime të pranueshme dhe ka ofruar standard të caktuar jetësor për bujqit. PPB ka buxhet prej rreth 55 miliardë euro, që paraqet 40% të buxhetit të përgjithshëm.



PARIMET BAZË TË POLITIKËS BUJQËSORE JANË:

- Tregu i vetëm – zbatohen rregulla për lëvizje të lirë të mallrave ndërmjet vendeve anëtare dhe i përkufizon qëllimet e vetme dhe mbështetjen, pa marrë parasysh selinë e ndërmarrjes (qëllimet e përbashkëta, pagesën e ndihmës, harmonizimin e rregullave në fushën e shëndetësisë dhe politikë të jashtme të përbashkët tregtare)
- Parimi përparësi të BE-së - përparësi u jepet prodhimeve bujqësore të BE-së në raport me produktet e importuara dhe e mbrojnë tregun e brendshëm nga ndërprerjet e shkaktuara nga importi i pakontrolluar i produkteve me çmim të ulët.
- Solidariteti financiar – parasheh se shpenzimet të cilat rezultojnë nga zbatimi i Politikës së përbashkët bujqësore, është se duhet të ndahet ndërmjet vendeve anëtare, pa marrë parasysh interesat e tyre nacionale.

QËLLIMET E POLITIKËS SË PËRBASHKËT BUJQËSORE:

1. **PRODHIM I QËNDRUESHËM I USHQIMIT** - ruajtja e potencialit për prodhimin e ushqimit në mënyrë të qëndrueshme që të sigurohet siguria afatgjate dhe qasshmëria e ushqimit, si dhe për rritjen e kërkesës globale për ushqim, e cila mund të rritet për 70% deri në vitin 2050.
2. **MENAXHIM I QËNDRUESHËM** – me resurset natyre dhe ndryshimet klimatike – furnizimi i qytetarëve produkte me cilësi të lartë dhe me produkte të vlefshme, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e ambientit jetësor, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, bimëve dhe shëndetin e njerëzve.
3. **ZHVILLIM I BARABARTË RAJONAL** - të ruhet komuniteti rural në të cilin aktiviteti prodhues bujqësor është ai i cili prodhon vende të reja pune, parasheh përfitime ekonomike dhe sociale dhe kontribuon për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

POLITIKA E PËRBASHKËT BUJQËSORE BAZOHET NË:

1. **POLITIKËN E TREGUT** – i barazon pagesat dhe masat e tregut **FONDI GARANTUES EVROPIAN BUJQËSOR (FGEB)**
2. **POLITIKËN PËR ZHVILLIM RURAL** – masa shumëvjeçare për zhvillimin e rajoneve rurale **FONDI BUJQËSOR EVROPIAN PËR ZHVILLIM RURAL (FBEZHR)**

Si të përzgjidhni farë të mirë



Shkruan: prof. dr. Gordana Pop Simonova

Gjatë furnizimit me material për farë, duhet të kihet kujdes për disa informacione të cilat duhet të vendosen në paketim. Emri i llojit apo hibridit - nëse përveç titullit qëndron edhe F1, domethënë se bëhet fjalë për hibrid dhe nuk mund të ruhet material për riprodhim për sezonin e ardhshëm. Përveç kësaj, farat hibride janë shumë më të shtrenjta se llojet, të cilat, shënohen me (OP). Prej këtyre llojeve mund të ruhet farë për sezonin e ardhshëm dhe kjo vetëm prej frutave të shëndetshme, tipike për llojin e caktuar. Më e sigurt është të veçohet fara nga frutat e tyre të para. Kur bëhet fjalë për domaten duhet të thuhet se a bëhet fjalë për lloje determinuese apo indeterminuese.



Mbirja farës është shprehur në përqindje. Pavarësisht se kur është prodhuar materiali i farës, mbirja dhe pastërtia kontrollohen çdo vit, derisa ajo të bjerë nën kufijtë e lejuar. Prandaj, në të njëjtën paketim mund të gjenden disa deklarata të ngjitura njëra mbi tjetrën. Tek farat për kopshtari, mbirja duhet të jetë rreth 100%. Në çdo rast duhet të fillohet me prodhimin e filizave, rekomandohet dhjetë fara të mbështillen në letër të lagur, në temperaturë dhome. Pas 7-10 ditësh duhet të mbijnë të gjitha farat. Kjo procedurë njëkohësisht do të ndihmojë edhe gjatë korrigjimit të normës së mbjelljes. Paketimi origjinal duhet të ruhet në rast nëse nuk ka përputhje me mbirjen e deklaruar dhe atë reale.

Për zgjedhja moderne fokusohet në krijimin e llojeve dhe hibridëve të cilët janë rezistencë apo tolerantë ndaj sëmundjeve aktuale. Në paketim shënohet: A për rezistencë ndaj urthit, F për rezistencë ndaj vyshkjes fusarioze (*Fusarium oxysporum*), V për rezistencë ndaj vyshkjes verticioze (*Verticillium albo-altrum*), N për rezistencë ndaj nematodeve, kure toleranca ndaj viruseve është shënuar me shkurtesën e virusit përkatës, për shembull, TMV për tolerancë ndaj virusit të mozaikut të duhanit.



LAGËSHTIA DHE TEMPERATURA E PËRSHTATSHME PËR ZGJIM

Pjesa më e madhe e kulturave të kop-shtarisë prodhohen me filiza. Në prodhimin e fidanëve ne jemi duke u përpjekur të imi-tojë kushtet natyrore në të cilat zhvillohet fara. Që të arrihen rezultate optimale për prodhimin e fidanëve, duhet të njihen bazat e biologjisë së farave. Çdo farë është një organizëm i gjallë që përmban një embrion (bima e ardhshme) dhe substanca rezervë që përdoren për ushqimin fillestar të embrionit deri sa të mbijë, përkatësisht derisa të fillojë të prodhojë vetë materiale për rritjen dhe zh-villimin. Embrionit dhe substancat rezervë janë të mbështjellë me shtresë fare.



Çfarë i nevojitet farës që të mbijë? Në parim, farat do të "zgjohen" kur lagështia dhe temperatura e tru-allit të jenë të përshtatshme. Në varësi nga prejardhja farat e perimeve kanë nevoja të ndryshme në raport me temperaturën dhe lagështinë e truallit. Në Republikën e Maqedonisë kultivohen perime me prejardhje tropikale dhe subtropikale (domatja, speci, kastravec), dhe është shumë e rëndësishme të sigurohet truall me lagështi dhe e ngrohtë. Kapaciteti truallit për ujë duhet të jesh midis 50% dhe 70%.

Perime	Temperatura maksimale e mbirjes	Javë deri në mbjellje
Kastravec	35°C	3-4
Spec	29°C	6-8
Domate	29°C	5-7
Lakër	29°C	5-7

Ekziston rekomandim për porozitetin e substratit ku mbillet fara. Farës trualli ku vendoset duhet të jetë i fortë, kurse mbulesa e butë. "Shtresa" e fortë siguron kontakt të mirë të farës me truallin (ose përzierjen e kop-shtit), kurse mbulesa duhet të jetë sa më e shkrifët që të mundësojë depërtimin e ajrit dhe frymëmarrja e farës. Fara, si dhe çdo organizëm i gjallë, merr ajër dhe nxjerr dyoksid karboni. Nëse nuk krijohen kushte dyoksidi i kar-bonit të dalë prej lehut apo saksisë - fara do të mbytet. Trashësia e mbulesës varet nga dimensionit i farës. Reko-mandohet të mos mbillet thellë. Thellësia duhet të jetë sa pesë deri tetë gjerësi të farës.

Që të mbijë fara e perimeve i nevojiten kushte të er-rëta. Pikërisht për këtë, midis të tjerave, lehet mbulohen me rrogos ose me material tjetër jo të tejdukshëm, de-risa bimët të mbijnë. Kur të mbijnë atëherë do të fillojnë ta përdorin dritën për rritje dhe zhvillim. ●



Baternat rezistues me shumë vitamina

Shkruan: Ivan Sholog

Baternat (Cucurbita moschata) është kungull muskant, por quhet edhe si kungull me aromë ose kungull sheqer. Ky është kungull me cilësi të jashtëzakonshme, shije dhe aromë specifike, të cilat më tepër përkujtojnë në aromën e bostanit ose pjeprit. Emri „baternat“ (Butternut) buron nga Amerika dhe në përkthim do të thotë „gjalpë“. Lloji të cilin e kultivojmë ka formë të dardhës dhe kryesisht është i mbushur me mish. Mishi është i trashë dhe i shijshëm, i ëmbël, me konsistencë fine dhe me ngjyrë të errët portokalli. Nga të gjithë kungujt, ky është më i mirë për byrek, ëmbëlsira dhe për ushqime të tjera. Përpunimi themelor i tokës duhet të jetë deri në 40 cm thellësi gjatë përpunimit në vjeshtë. Në pranverë duhet të mbyllet brazda për shkak të lagështisë, të bëhet përgatitja si për mbjelljen e misrit. Mbjellja kryhet me mbjellëse pneumatike për misër, me pllaka të veçanta të cilat kanë dyfish më pak vrima sesa në rastin të misrit. Pasi mbijnë kryhet kultivimi me kultivues për misër 2 ose 3 herë përdorësisht vegetacioni e lejon këtë gjë. Hapësira prej 10 cm ku është mbjellë kungulli, por i cili nuk është përpunuar me kultivator, duhet të prashitet me dorë ose me makina. Nevojitet pH-vlera e nevojshme e tokës të jetë 6,5 - 7,5. Me zbatimin e drejtë të teknologjisë fitohen 25.000 kg për hektar me çmim prej 0,14 €/kg ose 3.000 - 4.500 €. Neto të ardhurat me teknologji janë rreth 2.600 €. Baternat kungulli mbillet në fushë rreth 25 prill, ndërsa temperatura e tokës duhet të jetë më e lartë se 10°C. Mbillet me dorë ose

Me zbatimin e drejtë të teknologjisë fitohet 25.000 kg nga hektar për çmim prej 0,14 €/kg ose 3.000 - 4.500 €. Neto të ardhurat me teknologjinë arrijnë 2.600 €.



SËMUNDJE DHE DËMTUES

Kungulli baternat nuk është i ekspozuar ndaj sëmundjeve as ndaj sulmeve nga insektet. Megjithatë propozojmë mbrojtje parandaluese me preparat prej bakri (Nordox) deri në fazën e lulëzimit. Propozohet edhe trajtimi me biostimulues si dhe me ushqim nëpërmjet gjethëve, ndërsa lloji i ushqimit varet nga faza teknologjike. Dëmtime të caktuara mund të shkaktohet nga kërmij, nga minjtë e fushës etj.

me makina me mbjellëse pneumatike për misër. Fidanët mbillen në distancë prej 140x30 cm. Me atë arrihet të mbillen rreth 22.000 bimë për hektar. Mbillet në tokë e cila është përgatitur në mënyrë identike si për mbjelljen e misrit. Gjatë mbjelljes së rasatit ose farës me dorë nevojitet paraprakisht të përgatiten brazdat me mekanizim përkatës. Në tokë pjellore kungulli mund të mbillet disa vjet në parcelën e njëjtë, por nëse ekziston mundësi për rotacion të kulturës, sigurisht duhet të shfrytëzohet. Nuk ka nevojë të trajtohet kundër sëmundjeve dhe insekteve. Barishtet largohen me ndihmën e kultivuesit për misër dhe duhet të shkullet me dorë sipërfaqja e pa kultivuar

në gjerësi prej 10 - 15 cm ndërmjet bimëve. Operacioni i kultivimit duhet të përsëritet 2 deri në 3 herë derisa bima ende është e vogël. Ekziston mundësi edhe për mënyrë tjetër të largimit të barishteve, Por kultivimi është treguar si më i shpejtë dhe më i thjeshtë. Për barishte me gjethë të vogla lejohet trajtimi me herbicide. Rekomandohet hedhja e plehut, kombinim me Guanito, Pheniks dhe Italtollina. Nuk duhet të harrohet se baternat kërkon pleh më të dobët krahasuar me shumë kultura të tjera kopshtare. Hedhja e plehut varet nga kultura paraprake dhe nga rezultatet e fituara nga analiza kimike e tokës. ●

MBLEDHJA DHE MAGAZINIMI

Kungulli baternat, varësisht nga koha e mbjelljes dhe nga kushtet klimatike, mbledhet në korrik, gusht deri në tetor, sigurisht para akullit. Rregullisht mbledhet kur frutat fillojnë të ftojnë ngjyrë të verdhë pa njolla të gjelbra. Mbledhen frutat prej 550 deri në 1600 gram. Në kushte kur ka lagështi rekomandohet të mbledhen më herët, që të mos ndodhë paraqitja e njollave në vendet ku fryti e prek tokën.

Pa mbledhjes në verë, kungulli duhet të vendoset në hapësirë që të ftohet në 14-16°C. Kështu e ftohur është e gatshme për paketim dhe transport. Në temperaturë prej 16°C kungulli mund të rruhet deri në 12 muaj. Ruajtja deri në janar dhe shkurt garanton çmim të blerjes më të lartë se 25%, ndërsa humbja gjatë magazinimit matet me promil.

KUNGULLI I PASUR ME VITAMINA

Baternat është i pasur me sheqer, nisheste, acide organike, fermente, vitamina (A, B, C, E) dhe kripëra minerale (Kalium, kalcium, fosfor, hekur) dhe mikroelement. Kungulli muskant mund ketë deri në 20 mg β-karotin në 10 dkg fryt, që është për dy herë më tepër se në karota. që këtë fryt e vendos në vend të parë nga të gjitha produktet bimore të cilat njeriu duhet ti konsumojë. Efektet shëruuese të kungullit muskant bazohen në sasinë e madhe të paktin pëktinës e cila lidhet për materiet helmuese të sistemit të tretjes dhe kështu e pasturon organizmin, e përmirëson punën e veshkave, zemrës dhe enëve të gjakut. Frutat janë me ngjyrë të verdhë - portokalli. Në gatim përdoret në mënyrë të njëjtë si patatja - për byrek, bukë, brumë, supa, ëmbëlsira etj.

AGROXHEL

Karakteristika themelore e agroxeleve është fuqia e tyre e madhe absorbuese. Prodhimi është bioshpërbërëse, nuk e shkatërrojnë cilësinë e truallit kështu që këto preparate mund të përdoren në çdo lloj toke dhe për të gjitha kulturat bimore.



Shkruan: Dipl. agr. Dimitar Arnaudov

Vitet e fundit jemi dëshmitarë të fatkeqësive të mëdha klimatike, kurse një prej më të rëndësishmeve është ngrohja globale. Ngruhja globale, si edhe një sërë fatkeqësish të tjera makro dhe mikroklimatike kanë ndikim të madh mbi rendimentin në kulturat bujqësore. Një prej zgjidhjeve më të reja për luftë kundër tharjes (pasojë e ngrohjes globale) është agroXHeli apo hiforXHeli.

Në treg ky prodhim gjendet me emra të ndryshëm tregtarë, por qëllimi është i vetëm, d.m.th. absorbimi i përkryer i ujit. AgroXHeli mundëson përdorim racional të ujit nga bima.

Karakteristika kryesore e agroxeleve është fuqia e tyre e madhe absorbuese. Absorbimi i ujit është njëqind herë më i madh se pesha e tyre. Prodhimi është bioshpërbërëse, nuk e shkatërrojnë cilësinë e truallit kështu që këto preparate mund të përdoren në çdo lloj toke dhe për të gjitha kulturat bimore.

AgroXHeli krijon rezerva uji në rizosferë, kështu që absorbon të gjithë lagështinë rreth rizosferës dhe sasinë e mbetur e lëshon në shtresat më të thella të tokës, duke mos lejuar të krijohet lagështi e madhe relative në tokë që përfaqëson një rrezik të mundshëm për sëmundjes, në radhë të parë në sisteme e rrënjëve.

AgroXHeli është polimeri pangjyrrë me granula që e absorbon ujin, e zvogëlon, përkatësisht e optimizon nevojën për ujitje dhe është me dobi të madhe për rajonet e thata. Është e rëndësishme të theksohet se agroXHeli nuk e eliminon nevojën për ujitje.

Në shitje gjendet në formë të granulave apo pluhurit dhe me shtim të ujit bëhet xhel.

Në truall hidhet në thellësi nga 4 deri në 40 cm, në varësi nga kultura e cila kultivohet.

Për prodhim të fidanishtes në serë mund të hidhet në lehe dhe gjatë kësaj të inkorporohet në thellësi deri në 8 cm. Pastaj kryhet mbjellja e dhe kryhet ujitja e mirë. Për 10 m² nevojiten rreth 200 gr substrat.

Nëse përdoret në prodhimin në kontejnerë të fidanishtes, agroXHeli përzihet së bashku me substratin dhe kjo 3 deri në 4 kg për metër kub truall.

Në industrinë e prodhimit agroXHeli futet së bashku me farën, me pajisje të veçanta të cilat përdoren për futjen e insekticidit. Në këtë mënyrë procesi i mbirjes është më i shpejtë dhe nuk krijon kore trualli dhe fidani i ri është i mbrojtur nga tharrrja.

Për fidanishtet e mbjella inkorporoimi i agroXhelit bëhet në këtë mënyrë: tek çdo bimë duhet të hapim një gropëzë në zonën e rizosferës në thellësi prej rreth 20 cm dhe t'i trajtojmë me granulum të madh të agroXhelit. ●





Prodhim vere dhe uthulle prej molle

Zgjidhja më optimale për përdorimin e këtyre ideve të biznesit për prodhimin e uthullës është nëpërmjet fillimit të prodhimit të verës dhe zhvillimin e mëvonshme të prodhimit të uthullës ose prodhimit paralel edhe të verës edhe të uthullës, ku parësor do të jetë prodhimi i verës prej molle, kurse dytësor prodhimi i uthullës. Investimi kapital për prodhimin e kombinuar të uthullës dhe verës prej molle është përafërsisht 90.000 euro.

Uthulla e mollës futet në grupin e prodhimeve ushqimore më të shëndetshme të cilat përdoren si shtesë në ushqim. Konsiderohet se ka ndikim shërues dhe përdoret shumë gjatë dietave për dobësim. Në raste të caktuara mund të gjendet edhe në shitje në farmaci. Shpesh pakëtohet në paketime të vogla deri në 0,5 l, 0,75 l ose 1 litër me ambalazhim PET ose qelqi, por mund të gjendet në paketime edhe më të mëdha. Shpesh përqindja e aciditetit është 5%, por ka edhe prodhime me no 4%. Procesi tradicional i prodhimit të uthullës prej molle mund të zgjasë deri në 6 muaj, nëse zbatohet fermentim natyror dhe jo i përshpejtuar (d.m.th. Procesi i Orleanit).

Procesi i prodhimit mund të kryhet edhe për 4 javë nëse përdoren pajisje bashkëkohore (acetatorë - bioraktorë modernë) dhe zbatohet njohuria përkatëse për menaxhim me procesin

teknologjik (lider është Fringsi gjerman: www.frings.com). Në varësi nga procesi i prodhimit, prodhimi përfundimtar mund të ketë cilësi të ndryshme por edhe çmim të ndryshëm tregu.

Si prodhime më cilësore konsiderohen ato të cilat janë prodhuar në mënyrë tradicionale, me fermentim dhe pjekje prej më tepër muajsh dhe ato me fermentim të përshpejtuar me bioreaktorë, pa përdorim të shtesave dhe aromatisuesve. Në tregun vendas ka prodhime të ndryshme, si nga prodhuesit vendas ashtu nga ata të huaj të cilat dallojnë në cilësi dhe çmim të prodhimit.

Modeli i propozuar i biznesit përshin prodhim në rrugë natyrore, por proces të përshpejtuar dhe të kontrolluar, me përdorim të pajisjes bashkëkohore, pa shtesa dhe prodhim përfundimtar me cilësi të lartë. Më mirë është të përdoret prodhim i kombinuar verë dhe uthull.

Modeli më i mirë i biznesit për prodhim të uthullës së mollës është kombinimi me prodhimin e verës prej molle, për të cilën flasin edhe faktorët e mëposhtëm:

- Prodhimet e verës dhe uthullës lidhet ngushtë me njëri-tjetrin, kështu që procesi teknologjik i prodhimit të verës i paraprin prodhimit të uthullës.
- Fermentimi acid kryhet në verë, kështu që aciditeti i uthullës është pothuajse i barabartë me përqindjen e vëllimit të alkoolit në verë.
- Fermentimi alkoolik është sfidë teknologjike e fermentimit të uthullës, kurse njëkohësisht është më i gjatë (3-4 javë). Gjatë prodhimit të përbashkët kombinohen edhe njohuritë edhe angazhimi i teknologut.
- Investimi në prodhimin e uthullës është më i madh se për prodhimin verës, përkatësisht pajisja për prodhimin e uthullës mund të përdoret edhe për prodhimin e verës (dallimi i vetëm është në pajisjen e acetatorit).



Nëse prodhohet vetëm uthull, nevojitet prodhim dhe shitje e sasive të cilat janë të mëdha për tregun e Maqedonisë. Sasia minimale e nevojshme për arritjen e pragut të rentabilitetit gjatë prodhimit të uthullës është rreth 42.000 litra uthull në vit. Ky është një prag i lartë për rentabilitet të këtij prodhimi.

Zgjidhja më optimale për përdorim të këtyre ideve për biznes për prodhim të uthullës është:

- Fillimi i prodhimit të verës dhe zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit të uthullës ose paralelisht prodhimi i

verës dhe i uthullës, ku primar do të jetë prodhimi i verës prej molle, kurse dytësor prodhimi i uthullës. Investimi kapital për prodhimin e kombinuar të uthullës dhe verës prej molle është përafërsisht 90.000 euro. Për krahasim, investimi për prodhim të verës është 77.000 euro, që është mbi 85% e investimit të përgjithshëm për prodhim të kombinuar të verës dhe uthullës.

Mandej investimi për prodhim të uthullës në investimin për verë është vetëm 12.000 euro. •



BARËRA KUNDËR BARËRAVE TË KËQIJA

Ajo e zvogëlon kalimin e sëmundjeve midis kulturave sepse nuk i përket të njëjtës familje me shumicën e tyre. Me dendësinë e vet e zvogëlon erozionin dhe mbirjen e barërave të këqija në truall dhe lë një masë të madhe të materieve organike (mbi dhe në truall) e cila e përmirëson strukturën e truallit dhe kalbëzohet lehtë duke i furnizuar bimët me elementë ushqyes.

Shkruan: dipl. agr. Vanko Zahariev

Në kohën kur bujqësia po ballafaqohet gjithnjë edhe më tepër me sfidat e ndryshimeve klimatike dhe gjithnjë dhe më të mëdha janë nevojat për ushqim për mbijetesë në bletari dhe për stabilitet të agroekosistemit, shumë e dobishme është bima MUNGO (Guizotia abyssinica), që në gjuhën tonë do të përkthehej bar abisinie.

Mungo është bimë barishtore njëvjeçare e familjes Asteraceae me vegjetim shumë të shkurtër – rreth 70 ditë. Nuk ka lidhje me shumicën e kulturave të cilat kultivohen tek ne dhe si bimë nuk e duron të ftohtin sepse ngrin në temperatura nga minus 0,5°-1°C. Në kushtet tona rritet rreth 1 m. Lulëzon për një muaj pas mbirjes dhe zgjat tri javë. Lulet janë me ngjyrë të verdhë dhe diametër nga 3 deri në 5 cm.



Mungoja pllenohet me insekte dhe është bimë mjaltëdhënëse. Fara ka ngjyrë të zezë, me gjatësi 5-6 mm dhe gjerësi 0,5 mm. Meqenëse karakterizohet me rritje të shpejtë vegetative dhe vegjetim të shkurtër, e duron mirë thatësinë dhe nuk mund të shfaqet si bar i keq sepse nuk dimëron. Ajo e zvogëlon kalimin e sëmundjeve midis kulturave sepse nuk i përket të njëjtës familje me shumicën e tyre. Me dendësinë e vet e zvogëlon erozionin dhe mbirjen e barërave të këqija në truall dhe lë një masë të madhe të materieve organike (mbi dhe në truall) e cila e përmirëson strukturën e truallit dhe kalbëzohet lehtë duke i furnizuar bimët me elementë ushqyes. Si kulturë, për ne do të jetë interesante dhe të përfshihet në kultivimin e vazhdueshëm të monokulturave të bimëve të drithërave apo bimëve të drithërave dhe rrepën vajdhënëse, sepse në kushtet tona mund të mbillet në fillim të gushtit dhe të kositet ose mblidhet për farë deri në përgatitje për mbjellje të drithit vjeshtor ose rrepës vajdhënëse.

Mbillet në monokulturë në sasi 8-10 kg/ha ose në përzierje me facelia (*phacelia tanacetifolia*) ose kambanorja blu dhe jonxha e Aleksandrisë në sasi të përgjithshme prej të gjithave deri në 12 kg/ha. Përgatitja e truallit kryhet menjëherë pas vjeljes me operacione dhe pajisje për mbjellje të farërave të imëta.



Mbjellja kryhet në mënyrë manuale ose me makineri, në thellësi 1-2 cm. Meqenëse zhvillon një sistem të fuqishëm rrënjor, nevojat për ushqim i merr nga sasia e pashfrytëzuar e kulturës së mëparshme, ose të shtohet 10 kg/dynym ure para mbjelljes. Mungoja mund të korret pas lulëzimit, por para se të fillojë të plakët masa e bimës. Rendimenti i farës është deri në 60 kg/dynym, kurse e kashtës deri në 500 kg/dynym.

Me qëllim që të vërtetohen të gjitha vetitë e mësipërme të këtij bari, me farë të sjellë nga SEMENARNA – Slloveni, vendosëm të bëjmë prova para 2-3 vjetësh në 2-3 lokacione dhe arritëm të të dhënat se mbjellja duhet të kryhet sa më shpejt pas korrjes së drithërave ose të rrepës vajdhënëse, në sipërfaqe pa barëra të këqija rizome (sorgum etj.) dhe duhet të mbillet para një shiu të mirë, dhe me ushqim deri në 10 kg/dynym do të arrihet ajo që pritët. ●



Të mbjella me mungo në parcela për provë në rrethin e Vinicës.

Si u reflektua viti 2016 në sektorin bujqësor në rajon

Viti 2016 ishte i mbushur me një numër të madh problemesh dhe sfidash. Pikërisht kjo valë ka ndikuar edhe mbi sektorin bujqësor, që është ballafaquar me një numër të madh destabilizimesh. Ajo që edhe mandej mbetet problem janë, plasmani, blerja, ndikimi i ndryshimeve klimatike. Situatat politike dhe ekonomike kanë ndikuar, gjithashtu, edhe mbi bujqësinë. Çfarë e ka karakterizuar vitin që po kalon nëpër analizën e FFRMs-së, IKC-së, AgriNetit, Agropukës, të cilat janë involvuar drejtpërdrejt në këtë sektor.

Shkruan: Monika Risteska

**“Vit jostabil për bujqësinë në RM”,
Memet Sinani, zëvendëskryetar i
FFRM-së**



Viti që po kalon 2016 nuk ka sjellë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në stabilizimin dhe zhvillimin e bujqësisë si dega ekonomike më e komplikuar dhe më e mundimshme në Republikën e Maqedonisë. Luhatjet në PBV në përqindje dhe në vlerën monetare absolute tregojnë se masat ekzistuese dhe politikat bujqësore afatgjata nuk janë pasqyruar në stabilizimin e bujqësisë. Megjithatë, në bazë të analizave dhe argumenteve të FFRM-së mosekzistimi i masave dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për nënsektorët e bujqësisë, mund të shkaktojë rënie më drastike si në prodhimin bujqësor ashtu dhe në

marketingun e produkteve bujqësore në përgjithësi. Kështu, pothuajse një dekadë investimesh prej rreth 130-150 milionë në vit në bujqësinë ekzistuese ndikojnë dukshëm në mirëmbajtjen e kësaj dege të ekonomisë për më shumë se gati 1/3 e popullsisë.

Politika agrare i RM-së gjatë vitit që po kalon 2016 nuk ka ndryshuar, dhe kjo është një produkt i strategjisë kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, si dhe harmonizimin ekzistues të politikave të RM-së me politikat e BE-së, nëpërmjet procesit të vendosjes së mekanizmave dhe procedurave në lidhje me këtë aspekt. Kjo do të thotë se në sistemin për mbështetje të bujqësisë, RM-ja ka krijuar një mekanizëm i cili punon me sukses për të krijuar një politikë specifike bujqësore, duke përcaktuar masat dhe zbatimin e tyre në një shpërndarje në kohë dhe transparente të mjeteve për mbështetje. Gjithashtu, sistemi prodhon një nivel të duhur të të dhënave të përdorura në monitorimin përkatës të strukturës së fermave bujqësore, produktivitetin dhe nevojat e tyre. Funkcionaliteti i plotë dhe zbatueshmëria e këtij sistemi nuk mund analizohet plotësisht sepse ka ende masa të veçanta që RM-ja i promovon dhe aplikon në mbështetje të bujqësisë, kurse të cilat nuk janë dhe nuk mund të jetë pjesë e politikës së përbashkët bujqësore, për shkak të karakteristikës së tyre të shumëfishtë në kuptim të preferencës së produktit, ndikimit të drejtpërdrejtë në tregun e lirë, shkatërrimit të konkurrencës dhe kështu me radhë. Këto procese në aspektin e kohës pritët të përfundojë në 4-5 vitet e ardhshme, kur RM-ja duhet të harmonizojë plotësisht politikat bu-



jqësore me ato evropiane dhe pasojat e harmonizimit të nënsektorëve të shumta mund të jetë fatale.

Prandaj çdo ndryshim dhe zhvillim në këtë drejtim duhet të etiketohet si arritje specifike nga të cilat ne mund të mësojmë, që mund ta replikojmë dhe të aplikojmë. Në këtë aspekt 2016 në zhvillimin e bujqësisë ka shënuar:

1. Ligjet strukturore dhe mekanizmat e krijuara për bashkim apo konsolidimin e tokës bujqësore, të cilat kanë për qëllim të bëjnë tërësi bujqësore funksionale dhe konkurruese që do të kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit bujqësor dhe rritjen e mundësive të tregut.
2. Shpërndarjen e fermerëve të vegjël në kooperativave bujqësore si një mundësi për bashkimin e prodhimit, përmirësimin e teknologjive të prodhimit dhe rritjes së konkurrencës.
3. Përmirësimin e kriterëve dhe kushteve për programin IPARD 2 që është më e arritshme për fermerët e vegjël dhe të mesëm dhe mundëson përmirësimin e infrastrukturës rurale dhe zhvillimin rural.



4. Mbështetjen e teknologjive të qëndrueshme të prodhimit nëpërmjet masave të tjera për vendosjen e sistemit pikë për pikë, mbështetje për furnizim me material fidanor me cilësi të certifikuar, mbështetje në masat për përmirësim të cilësisë së prodhimit (klasifikimi, përzgjedhja etj).
5. Mbështetjen në procesin e prokurimit të pajisjeve të cilat në masë të madhe e përmirësojnë efikasitetin e resurseve të investuara njerëzore dhe materiale.
6. Masat për të stimuluar fermerë të rinj dhe gra bartës të ekonomisë bujqësore që ndikojnë në uljen e migrimit, ndryshimin nga prodhimi tradicional në atë tregtar, stimulojnë barazi gjinore dhe i përmirësojnë kushtet sociale në zonat rurale.

Këto janë vetëm disa nga të arriturat, por edhe problemet në sektorin e bujqësisë. Prandaj, le të shpresojmë dhe të punojmë që kushtet të përmirësohen dhe të japin rezultate më të mira çdo vit. ●



**“Prodhi bujqësor nuk është rritur, por janë rritur eksportet,”
Tomi Pikuli, Drejtor ekzekutiv i
Fondacionit AgriNet Albania**

I gjithë viti 2016 për sektorin e bujqësisë është e karakterizuar nga sfida të ndryshme në prodhimtari si dhe në fushën e marketingut. Në parim, prodhimi bujqësor nuk është rritur ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme për shkak të disa arsyeve, siç janë kushtet e pafavorshme të motit si dhe çmimet më të ulëta në tregjet e brendshme dhe të jashtme. Sektori i pemëtarisë ishte dëmtuar pjesërisht nga temperaturat e ulëta dhe reshjeve gjatë periudhës së pranverës, që rezultoi me dëmtim të prodhimit në aspektin cilësor dhe sasior. Ndërsa në sektorin e perimeve ka pasur luhatje të mëdha në koston e shitjeve gjatë periudhave të ndryshme, prodhimi i ullirit është rritur në krahasim me vitin e kaluar, si në sasi ashtu dhe në cilësi.

Ka pasur përmirësime në eksportin e produkteve bujqësore në vendet nga rajoni si Maqedonia, Kosova, Serbia dhe Greqia, të cilat ndihmuan në mënyrë të konsiderueshme në procesin e shitjes së prodhimit. Gjithashu, rritja në përpunimin dhe ruajtjen e kapacitetit i ka ndihmuar fermerët në marketingun e prodhimit. Fondacioni AgriNet Shqipëri gjatë vitit 2016 →



“Viti 2016 një vit produktiv për bujqësinë në Kosovë,” Ekrem Bajrami, Drejtor ekzekutiv në IKC

→ ka zhvilluar një program të gjerë të aktiviteteve me shoqatat e fermerëve në Korçë, Elbasan dhe rajonet e Dibrës. Në këtë kontekst, 14 shoqatat e fermerëve të cilët kultivojnë fruta, perime dhe ullinj ishin fokusi i mbështetjes në kuadër të projektit “Zhvillimi i komunitetit rural përmes Shoqatës së fermerëve” e mbështetur nga We Effect, Suedi.

Ndër aktivitetet kryesore që zbatohen gjatë këtij viti janë:

- Mbështetja në forcimin dhe rritjen e kapacitetit të organizimit dhe funksionimit të shoqatave të fermerëve me qëllim krijimin e mundësive të përfitimit dhe avantazheve që sjell ky organizim në rritjen e prodhimit dhe tregëtimit e tij;
- Teknologjitë e reja për prodhimin e frutave, perimeve dhe ullinjve ishin subjekt i zhvillimit të trajnimit për fermerët me qëllim që të përmirësohet cilësia dhe të përmbushen standardet e tregut të brendshëm dhe të jashtëm;
- Janë zhvilluar një numër i madh i vizitave për të shkëmbyer përvojat me qëllim të rritjes së njohurive të fermerëve në lidhje me teknologjitë moderne, standardizimin e prodhimit të tyre dhe shitjes së tyre. Këto vizita kryhen brenda dhe jashtë vendit, siç janë Greqia dhe Maqedonia;
- Promovimi i produkteve bujqësore përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme siç janë panairët nacionale dhe rajonale, të cilat krijojnë mundësi për njohjen e produkteve komerciale dhe kujdesen për marketingun e tyre. Gjithashtu, aktivitete të përbashkëta promovuese janë zhvilluar në bashkëpunim me shoqatat e fermerëve nga Shqipëria dhe Maqedonia;
- Një nga aspektet kryesore të zbatimit të projektit ka qenë pjesëmarrja e grave nga vendet rurale në aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij viti. Për herë të parë në rajonin e Korçës u themelua Forumi rural rajonal i grave, i cili do të jetë një mjet për të përfaqësuar zërin e grave në shoqëri dhe rritjen e rolit të tyre në vendimmarrje. Janë zhvilluar aktivitete dhe seminare të shumta në këtë kuadër mbi tema të ndryshme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, pjesëmarrje në konferenca të ndryshme dhe panairë brenda dhe jashtë vendit, si dhe trajnime të ndryshme për rritjen e rolit të grave në udhëheqje;
- Aktivitete të ndryshme lobuese janë zhvilluar si dhe pjesmarje në aktivitete të rrjeteve të bashkëpunimit të Fondacionit AgriNet Albania brenda dhe jashtë vendit;
- Një tjetër aspekt i punës së Fondacionit AgriNet Shqipëri është nxitja e të rinjve për të marrë pjesë në aktivitetet bujqësore dhe për t'i rritur kapacitetet e tyre profesionale;
- Për aktivitetet e ardhshme kryesisht do të fokusohen në organizimin drejtë shoqatave të qëndrueshme të fermerëve, mbështetje e iniciativave të reja për t'i rritur kapacitetet teknike, për t'i përmbushur standardet e tregut në prodhimin bujqësor, për ta përmirësuar marketingun dhe krijimin e kooperativave bujqësore;

Pjesëmarrja e grave në aktivitetet të ndryshme sociale dhe ekonomike do të jetë një nga qëllimet e zbatimit të projektit duke rritur rolin e tyre në vendimmarrje, udhëheqje dhe barazi gjinore. ●

Të nderuar lexues

Edhe për kundër problemeve që e përçjellën bujqësinë kosovare gjatë vitit 2016, lirisht mund të themi se viti 2016 ishte vit produktiv. Ky vit shoqërua me të reshura mesatare për dallim nga viti i kaluar që ishte me thatësira ekstreme. Këto kushte meteorologjikë ndikuan që të kemi një prodhimtari solide si në sektorin e drithërave e pemëve ashtu edhe të perimeve.

Prodhuesit e dredhëzave edhe pse nuk realizuan një prodhimtari rekorde (për shkak të dëmeve nga bora e vonshme) nuk mund të themi se nuk realizuan të hyra të mira. Këtë vit, për dallim nga viti i kaluar, dredhëza kishte një çmim shumë më të mirë. Për kundër kësaj prodhuesit e mjedrës nuk ishin shumë të kënaqur me çmimin grumbullues të saj prej (1.3 €), mirëpo falë rendimentit të mirë kjo u kompensua në realizimin total të fitimit për ta. Edhe sikurse viteve të kaluara ashtu edhe këtë vit, fermerët kosovarë vazhduan me mbjelljen e sipërfaqeve të reja me kulturën e mjedrës. Mjendra do të jetë edhe më tej një kulturë e preferuar e fermerëve kosovarë dhe si një mundësi për punësim dhe ngritje të standardit jetësor. Si duket kushtet klimatike në Kosovë ofrojnë kushte ideale për kultivimin e kësaj kulture, mirëpo kufizimi vetëm në një varietet në këtë rast varietetin “Polka”, mund të sjell probleme në plasmanin e mëtutjeshëm. Fermerët kosovarë duhet që të fillojnë me kultivimin e varieteteve më fitim prurës të mjedrës siç janë; Villamet, Meeker, etj si dhe varietetet e tryezës. Gjithashtu duhet që të fillohet të mendohet në kultivimin e Boronicës së butë (në ato vende ku ph e tokës ofron këto kushte), pasi që për frutat e kësaj kulture ka kërkesa të mëdha në tregun e EU.



IKC gjatë viti që lamë pas ka ndihmuar fermerë të ndryshëm në sektorë të ndryshme në 11 komunat e Kosovës. Duke falënderuar dy donatorët tonë kryesor për vitin 2016; We Effect dhe Ambasadën Britanike në Prishtinë si dhe duke mos lënë anash as qeveritë lokale të komunës së; Vitisë, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit, etj. Falë këtyre donatorëve ne arritëm që të përkrahim një numër të konsiderueshëm të fermerëve me trajnime, promovim të produkteve të tyre si dhe me grante direkte. Me qëllim të promovimit sa ma të mire të produkteve vendore e me këtë edhe prodhimet e shoqatave partnere, IKC gjatë vitit 2016 ka organizuar 4 panaire (3 panaire 1 ditore dhe 1 panair 3 ditore):

Shoqatat partnere me të cilat IKC ka punuar gjatë vitit 2016, qofshin ato të themeluara apo të përkrahura nga IKC, kanë realizuar suksese të konsiderueshme në rrugën drejt pavarësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Shumica prej tyre kanë realizuar projekte të ndryshme në të mirë e anëtarëve të tyre, kështu duke bërë hapat e para në gjenërimin e të hyrave.

Një bashkëpunim shumë i mirë gjatë 2016, ka qenë edhe me komunat në të cilat ne kemi të shtrirë aktivitete tona. Mirëpo, për fat të keq jo me të gjitha komunat ku ne veprojmë kemi pasur një bashkëpunim të kënaqshëm, vlen të theksohet se jo për fajin e IKC ka munguar ku bashkëpunim.

Ndër problemet kryesor që e ka përcjell bujqësinë kosovarë në vitin 2016 pa dyshim mbetet sëmundja gungore e gjedheve apo LSD si dhe problemet me cilësinë e materialit fidanor të mjedrës. Sëmundja gungore e gjedheve edhe pse është pritur se do të përhapet edhe në Kosovë (pasi që u alarmua për prezencë e saj në Serbi dhe Maqedoni), autoritetet Kosovare i zuri të pa përgatitura. Si rezultat i kësaj u prekën 649 ferma dhe fermerët kosovarë kanë humbur 1301 gjedhe (të ngordhura vetëm brenda 6 muajve). Shumë paqartësi mbizotëruan në lidhje me këtë sëmundje si te fermerët kosovarë ashtu edhe te konsumatorët e mishit të gjedhit për atë se a është për konsum mish dhe bylmeti i këtyre gjedheve të sëmurë. Sido që të jetë lirisht mundë të themi se autoritete e Republikës së Kosovës dëshuan në parandalimin apo minimizimin e dëmeve nga kjo sëmundje. Kjo thënie vlen aq më tepër kur dihet fakti se një dozë e vaksinës kundër kësaj sëmundje kushton vetëm 2€.

Me nderime
Ekrem Bajrami
Drejtor Ekzekutiv në IKC ●



"Puna për përmirësimin e të ardhurave," Sabah Gjaloshi, Drejtor ekzekutiv i AgroPuka, Shqipëri

Agropuka me mbështetje të We effect kontribuoi në përmirësimin e qëndrueshëm të kushteve të jetesës. AP prej nëntorit 2011 deri në dhjetor të vitit 2013 dhe pastaj nga viti 2014 deri në 2016 e implementoi projektin "Kontributi i qëndrueshëm për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë rurale në Pukë", i mbështetur dhe financuar nga We Effect - Qendra kooperative Suedeze (Swedish cooperative center - SCC). Projekti synon të përmirësojë kushtet e jetesës së target

grupeve dhe kjo do të jetë, ndërmarrje e masave që do të çojnë në rritjen e të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe të promovojnë demokracinë lokale dhe pjesëmarrjen. Projekti i identifikon dhe promovon modelet e bashkëpunimit në fushën e prodhimit dhe marketingut, barazinë gjinore, pjesëmarrjes dhe demokracisë në nivel lokal. Target grupet përfshijnë: Anëtarët e AP, prodhuesit që prodhojnë produkte cilësore dhe i shesin me ndihmën e marketingut të AP, gjashtë grupet e interesit të grave të cilat nëpërmjet kontributeve të tyre, ndihmojnë në përmirësimin e pozitës sociale dhe ekonomike të grave në Pukë.

Rrjetizim dhe imazhi i përmirësuar i AP, nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjes në rrjetet siç është Rrjeti Shqiptar për Zhvillim Rural i themeluar në Pukë në vitin 2015; pjesëmarrja në rrjetet rajonale, ballkanike dhe evropiane, siç janë takimet përgatitore, panairi në Nikshiq në Mal të Zi, etj. AP ishte i pranishëm në disa stacione televizive kombe të si: Top Channel, News 24, Vizion Plus, A1 Report, Zëri i Amerikës, etj, ku rezultatet e arritura nga Agropuka dhe pas paraqitjes së projektit gjithashtu u paraqitën produktet e prodhuesve të Pukës. ●



Masa për mbrojtje nga përmytjet



Në mbrojtje nga përmytjet dallim të madh ka midis përmytjeve prej lumenjve dhe rrebesheve.

Tek rrebeshet kryhet riparim i të gjithë rajonit të koritës dhe fillohet nga pjesët e sipërme me qëllim që të mbahet uji dhe të vazhdohet koha e rrjedhjes, kurse kjo bëhet me pylëzim dhe me masa të tjera rezenive (kanale për divergjencë të ujërave, të pellgjeve për retencë të përkohshme etj.) Përveç kësaj është me rëndësi të mbrohet korita prej erozionit sepse kjo ndikon shumë mbi dëmet e shkaktuara nga përmytjet prej rrebesheve. Për këtë qëllim janë të rëndësishme masat kundër erozionit dhe mbajtja e prurjeve në pjesën e kanionit të rrëkeve.

Nëse mungojnë masat kundër erozionit ose janë të pamjaftueshme atëherë prurja zakonisht bie në rrëzë të malit në pjesën e rrafshët ku zakonisht e mbulon koritën me sediment, por edhe urat, duke shkaktuar dalje

të ujit dhe përmytje të tokës përreth. Nëse vjen ujë relativisht i pastër është e madhe mundësia që të mos dalë nga korita, por nëse është një sasi e madhe e prurjes me siguri që do të dalë.



Fotografi 46. Reçica, 2015



Fotografi 47. Radovish – përroi Sushica, 2008

Me ligj, rregullimi i pellgjeve të përrenjve është detyrë e vetëqeverisjes lokale dhe ujësjellësit kompetent, por këtu duhet të përfshihet edhe ND “Pyjet e Maqedonisë” (për shkak të aktiviteteve të) si edhe popullatës lokale.

Gabime të cilat i bën popullata lokale dhe që kontribuojnë në zmadhimin e dëmeve:

- Prerje e jashtëligjshme e pyjeve;
- Zvogëlim i koritës së rrjedhjes së ujit me hedhjen e mbeturinave dhe uzurpimin dhe shndërrimin në tokë të punueshme, si dhe ndërtimet e paligjshme në koritë (vendkalime);
- Ndërtimi i shtëpive në afërsi të zonës së përmytur duke u rrezikuar në këtë mënyrë;
- Hapje të shtëpive kah koritës të cilat nuk janë rezistente ndaj llavës së rrebeshit.

Zakonisht lokacionet e fshatrave rrëzë malit janë të papërshtatshme sepse janë vendosur në të a.q. kone të kaltra të poreve dhe ndërtohen shtëpi në vende të papërshtatshme. Shembulli i vetëm i mirë është fshati Poroj (Tetovë) ku nga përvoja shumëvjeçare me rrëketë në pjesën më të rrezikshme nuk ka asnjë shtëpi.



Fotografia 48. Lokacioni në fshat në t.a. kon i kaltër



Fotografia 49. Lokacioni i vetëm përkatës (fsh. Poroj)

Në shembullin e Shipkovicës në katin e poshtëm gjendet një dritare anësh nëpërmjet të cilës u fut lava e rrebeshit dhe gjatë kësaj kanë humbur jetën 3 persona.

Hulumtimet tona në rajonet e përmytura në rrethinën e Shkupit dëshmuar se në truall nuk ka prani mikroorganizmave koliforme dhe Escherichia coli të cilat e kanë prejardhjen nga materiet organike me prejardhje fekale. Gjithashtu, në truall nuk janë konstatuar klostridë si dëshmues të zhvillimit të proceseve anaerobe në truall të cilat janë negative dhe të padëshirueshme në prodhimin bujqësor, sepse e zvogëlojnë biogjenitetin dhe pjellshmërinë e truallit. Kjo do të thotë se në këto sipërfaqe pas ndërmarrjes së masave agroteknike dhe përmirësuese mund të kultivohet ushqim i shëndetshëm dhe i sigurt. ●

MASAT JANË:

- Zbatimi i masave agroteknike dhe tekniko-përmirësuese në sipërfaqet e punueshme dhe zbatimi i masave të kombinuara përmirësuese e të pyllëzimit të tokave të papërpunueshme dhe të tokave në pyjet e degraduara apo të shkatërruara në terrenet malore.
- Heqja e skeleteve të sjellë (shkëmbinjt, çakall dhe rrëzë të trashë) prej sipërfaqeve më të vogla: kjo masë kryhet manualisht, kurse në vendet ku prurja është më e madhe të përdoret mekanizimi përkatës.
- Sjellja e materialit glinë, ku është marrë shtresa e përpunuar humuse-akumuluese.
- Zbatimi i përpunimit të thellë me përzierje të shtresave me tekstura të ndryshme, sidomos aty ku në thellësi përzihen shtresat ranore dhe të glinës, do të mundësohet nëpërmjet investimeve jo kaq të theksuara të përmirësohet produktiviteti i truallit.
- Përpunimi themelor (lërimi) të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur (para dimrit), në një thellësi sa më të madhe (30-35 cm) duke u lëruar kështu rëra e imët që ka mbetur në sipërfaqe pas tërheqjes së ujit.
- Të mos ndizen mbetjet, të lërohen së bashku me lërimin thellë vjeshtor, me plug.
- Hedhje e rregullt e plehrave organike, me qëllim që të zmadhohet humusi i sjellë dhe përmirësohet njëkohësisht struktura e truallit, si dhe hedhje e rregullt e plehrave minerale, sidomos kaliumit, fosforit dhe azotit, me qëllim që të zmadhohet pjellshmëria e truallit.
- Zbatimi përkatës i mbjelljes së kulturave bujqësore. Të anashkalohet kultivimi i të njëjtës kulturë në sipërfaqe të njëjtë (monokulturë) dhe të futen në mbjelljen e kulturave kulturore foragjere apo kulturave të tjera për plehërim të gjelbër.
- Në pjesët ku prurjet janë shumë të thella më tepër se 1m (diku vumë re dhe përmytje të tërësishme të të mbjellave me dardha) është e nevojshme heqja e prurjeve me mekanizim dhe hedhje të tyre në vend tjetër (deponi e përkohshme) ku mund të gjejnë zbatim si material për ndërtim për aktivitete të caktuara. Në këto vende masat për rikultivim janë më të koklavitura dhe efektet pozitive do të merren pas një periudhe më të gjatë.



Ndërtesa të vendosura në mënyrë jo të drejtë në koritë apo në drejtim të përroit

Reçica, Shipkovicë, Straçinci

Urbanizimi jopërkatës Stajkovci, Singeliq




Fotografia 50 dhe 51. Ndërtesa të vendosura në mënyrë jo të drejtë në koritë



Uzupirimi i koritës Lumi Creshevska




Mbeturina në koritë - Straçinci



Hapje/dritare kah koritës Straçinci dhe Shipkovicë



Kalim i ndërtuar në mënyrë jo të drejtë - Bërjarci



Makina për mbulimin dhe vendosjen e folive plastike

Shkruan: Prof. dr. Dragi Tanevski, Fakulteti për Bujqësi, Shkencë dhe Ushqim - Shkup

Mbulimi për herë të parë ka filluar të përdoret në Havai, në plazhet me ananas, me qëllim të ndalohet rritja e farës së keqe, ndërsa më vonë këtë masë e kanë pranuar edhe për kultivimin e luleve.

Përveç se për ndalimin e rritjes së farës së keqe, mbulimi shërben edhe për ndalimin e avullimit të ujit, me çka ruhen vetitë fizike dhe kimike të tokës. Kjo masë e ndalon paraqitjen e kores dhe e përshpejton mbirjen dhe zhvillimin e bimëve gjatë vegjetacionit, që mundëson mbledhje më të shpejtë, dhe me këtë edhe çmim më të lartë në treg.

Mbulimi kryhet në mënyrë speciale, me makina të konstruara për këtë qëllim. Mbulimi me makina moderne për mbulimin e tokës me film plastikë ose foli, kryhet në parcelat dhe në vend të mbrojtur. Në parcelat, mbulimi kryhet në sipërfaqe të rrafshët dhe në tratë të vegjël. Parakusht themelor për realizimin me sukses të këtij operacioni është sipërfaqja e rrafshuar mirë. Përdoren foli me trashësi prej 0,014 mm, të errësuar, të cilat mund të jetë polietilen linear ose foli që shpërbëhet biologjikisht.

Perspektivat e mbulimit janë të mëdha, sepse përdoren në sipërfaqe shumë të mëdha. Sekret i veprimit të mbulimit është stimulimi i bimëve nëpërmjet efektit të temperaturës, e cila është më e lartë edhe për 10°C, në krahasim me sipërfaqen e zbuluar. Gjatë kësaj uji ruhet gjatë vegjetacionit (40 – 50 mm).

Makina për mbulim dhe vendosjen e folive mund të jenë makina individuale ose makina për mbjellje të cilat kanë të instaluar pajisje për vendosjen e folive të plastikës.

Makina për mbulimin dhe vendosjen e folive plastike.

Këto makina agregohen në sistem të përbashkët hidrolik nga traktori. Në pjesën e përparme të makinës ka cilindër të lëmuar, i cili ka për detyrë në mënyrë plotësuese ta rrafshojë sipërfaqen e tokës. Folia plastike gjendet e mbështjellë në spirale. Mbrapa cilindrit të lëmuar janë vendosur shata të vogla të cilat kanë për detyrë të formojnë kanale, në të cilat mund të vendoset fundi i folisë plastike me ndihmën e rrotave shtypëse. Mbrapa shatave të vogla, dhe para rrotave shtypëse, gjendet pajisja për drejtim e cila



Makina për mbulimin dhe vendosjen e folive plastike





Makina për mbulimin dhe vendosjen e folive plastike



Makina për mbulim dhe mbjelljen e drejtpërdrejtë të fidanëve në sipërfaqe të mbrojtur



ka për qëllim të shtrijë folinë në sipërfaqen e parcelës paraprakisht të rrafshuar. Mbrapa rrotave të saj gjenden trupa punues, kapëse, të cilat skajet e folisë plastike i mbulojnë me tokë (rreth 20 cm nga secila anë). Në këtë fazë, me rëndësi është folia të jetë mirë e shtrënguar në gjatësi dhe gjerësi. Shtrëngimi në gjatësi kryhet me ndërprerës me fërkim e cila është e vendosur në skajet e spirales dhe në të cilën është e vendosur folia, ndërsa shtrëngimin e folisë në gjerësi e kryejnë rrotat shtypëse të cilat zakonisht janë të vendosura nën kënd prej 20° deri në 30°.

Mbulimi i mekanizuar i tokës me foli plastike në objekte moderne me hapësirë të mbrojtur kryhet me makinat e njëjta të cilat përdoren për vende të hapura.

Sot më shumë, përdoren foli plastike të përpunuara nga polietileni me dendësi të ulët. Folitë e ngushta të plastikës përdoren për prodhimet e hershme kopshtare. Mbledhja e folive që nuk shpërbëhen, kryhet me dorë, në mënyrë gjysmë të mekanizuar dhe të mekanizuar.

Përveç folive që nuk shpërbëhen, përdoren edhe foli që shpërbëhen të krijuara nga materiale sintetike polimerë, siç janë filmat plastikë fotoshpërbërës dhe bioshpërbërës. Filmat plastik fotoshpërbërës, shpërbëhen nën ndikimin e dritës së diellit pas një numri të caktuar të ditëve nga momenti i vendosjes së tyre (zakonisht 90 ose 120 ditë). Mirëpo, duhet të theksohet se shpërbërja e folisë kryhet vetëm në pjesën që është e ekspozuar nën ndikimin e dritës së diellit, ndërsa skajet e folisë të cilat janë të mbuluara me tokë ngelin të pa shpërbëra. ●



Makina për mbulim dhe mbjelljen e drejtpërdrejtë të fidanëve



Prezantim i biznes planeve dhe punëtori për menaxhim dhe biznes planifikimi në kooperativë



Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë, mbajti prezantim në lidhje me biznes planet e përpiluara nga kooperativat të cilat morën pjesë në programin për edukim të dedikuar për kooperativa bujqësore, e organizuar në suazat e Projektit “Mbështetje institucionale për FFRM”, e mbështetur nga We Effect. Qëllimi i evenimentit ishte të theksohet rëndësia e biznes planeve dhe edukimi i dedikuar për kooperativat për zhvillimin e shoqërimit në kooperativa bujqësore. Aktivitetet për kooperativat, FFRM, i implementoi në bashkëpunim me Asociacionin Maqedonas për Kooperativa Bujqësore. Njëkohësisht në evenimentin e njëjtë u prezantua glikoja nga karota e prodhuar në mënyrë tradicionale pa përdorimin e kimikateve, si produkt përfundimtar i kooperativës “Eko Ilinden” dhe si aktivitet i fokus grupit të kooperativës në fjalë e formuar në suazat e projektit „Mbështetje institucionale e FFRM”.

Si pjesë e këtij eventi menaxhuesi i projektit Biljana Petrovska - Mitrevski, i prezantoi aktivitetet e punuara në suazat e projektit „Mbështetje institucionale e FFRM”, duke theksuar se nevojitet pjesëmarrje e përbashkët dhe koordinim për shkak të lobimit më të qëndrueshëm dhe më të shprehur në interes të kooperativave. „Rritja e informimit dhe edukimi në lidhje me menaxhimin, marketingun, por edhe teknologjitë për prodhim. Profesionalizimi i ekipit i cili punon në kooperativë, në veçanti menaxherit profesional në kooperativë bujqësore.

Harmonizimi i normave ligjore me nevojat e kooperativave që të nxitet zhvillim (shitje e zmadhuar, pjesëmarrje etj.). Përkushtim dhe fokus në mbështetjen e kooperativave nga donatorë në pjesën e shoqërimit ekonomik të bujqve”, tha Petrovska - Mitrevska. KB „Agro Bogdanci” nga Bogdanci e prezantoi biznes planin për ndërtimin e hapësirës për stratifikim dhe shartimin e fidanëve të vreshtave dhe fidanëve frutor, KB „Agroekonomija Trejd” nga Mogila me biznes plan për furnizimin e mekanizimit - kombajnë, Ekokooperativa Kriva Pallanka me biznes plan për furnizimin e mekanizimit për bletari mobile, KB “Eko Fasule” me biznes plan për furnizimin e mekanizimit dhe përpunimin e fasules, KB “Eko Ilinden” me biznes plan për furnizimin e pajisjes për paketimin e jonxhës në peleta. Suzana Dimitrievska, menaxhere e Eko-Ilinden mbajti një prezantim të shkurtë për pilot projektin për prodhimin e glikosë prej karotat në mënyrë tradicionale, si fryt i grupit të fokusit të kooperativës në fjalë, ndërsa FFRM-ja në detaje e tregoi të gjithë procesin e përpunimit të glikosë nga karota deri te prodhimi përfundimtar nëpërmjet një filmi të shkurtë. Bllagojce Najdovski gjithashtu mbajti prezantim për vizitën studimore në kooperativat në Slloveni dhe Kroaci dhe tregoi se cilat janë karakteristikat kryesore të kooperativave të suksesshme në ato rajone, bëri krahasim me vendin tonë dhe theksoi se mbrapa kooperativave të suksesshme qëndron, menaxher i suksesshëm, i gjindshëm dhe i mirë arsimuar.

Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë (FFRM) dhe Asociacioni Maqedonas i Kooperativave Bujqësore (AMKB) dy ditët e ardhshme e realizuan punëtorinë e fundit për menaxhim dhe planifikim afarist të kooperativave bujqësore. Qëllimi i takimit ishte të analizohen veglat e biznes planifikimit dhe komunikimit afarist të cilat do të ndihmojnë në të gjithë zhvillimin e kooperativave bujqësore. Ky trajnim, gjithashtu, u realizua në suazat e projektit “Mbështetje institucionale e FFRM-së”, e implementuar nga FFRM, dhe e mbështetur nga organizata suedeze We Effect, ku ligjërues ishte profesori Mile Peshevski nga Fakulteti Për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim. Gjatë punëtorisë u prezantuan shembuj praktik për organizim të mirë të kooperativës dhe u diskutua për problemet aktuale të mënyrat për zgjidhjen e tyre. Të gjithë pjesëmarrësit të cilët në mënyrë aktive ishin të përfshirë në programin edukativ për kooperativa bujqësore që përbëhej nga 4 trajnime në fund të vitin përfundimtar u pajisën me Certifikata për pjesëmarrjen dhe aftësimin e tyre. Në punëtorinë u promovua projekti “Komiteti nacional për bujqësi familjare në RM”, i mbështetur nga FAO, IFAD dhe Forumi Rural Botëror, ndërsa i implementuar nga FFRM, RZHR, Instituti për Zhvillimin e Komuniteteve.

Sipas Nikolla Stamenov, kryetar i FFRM-së ka bërë me dije se që të mundësohet zhvillim i kooperativave duhet në mënyrë të këtillë të bashkuar dhe të organizuar të veprohet dhe të vazhdohet me edukimin e menaxherëve në kooperativat bujqësore. ●





Paraqitje e organizuar tek institucionet kompetente

Liderët e grupeve nënsektoriale në suazat e FFRM-së mbajtën takim ku u diskutua në lidhje me aktivitetet dhe ndërtimin e strategjisë, e cila duhet të vendoset për paraqitje më të mirë të Federatës te institucionet kompetente për lobim dhe njëkohësisht u shqyrtuan Programi për mbështetje rurale dhe Programi për pagesën e drejtpërdrejtë – subvencione. FFRM, do të dalë me qëndrimin e vet në pjesën e ndryshimeve të këtyre programeve, të cilat do të jenë në drejtim të zhvillimit të bujqësisë. Gjatë takimit u theksua se nevojiten investime në bujqësi, plasman i garantuar dhe paraqitje e organizuar në tregjet. Para mbajtjes së takimit me grupet nënsektoriale, Këshilli drejtues i FFRM-së, realizoi takim gjatë së cilit u shqyrtua puna në vijim e organizatës dhe theks i veçantë u vendos te lobimi, për çka FFRM-ja periudhën në vijim do të punojë me strategji të veçantë. Gjatë takimit u prezantua edhe projekti “Komiteti nacional për bujqësi familjare në RM”, i cili u implementua nga FFRM, RZHR dhe Instituti për Zhvillimin e Komuniteteve. ●



Aktiviteti është pjesë e projektit “Mbështetje institucionale e FFRM”, e mbështetur nga We Effect

Pse të kaloj në prodhues organik

Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet projektit “Mbështetje institucionale e FFRM”, e mbështetur nga We Effect së bashku me Projektin IME (Increasing Market Employability - IME) organizon trajnim për prodhim organik në të cilin të ftuar ishin përfaqësues të Agro Qendrës për Edukim dhe Ballkan Biosert. Evenimenti u mbajt në Kontakt Qendrën Zvicerane në Shkup, ndërsa i njëjti u dedikoj anëtarëve të Rrjetit të Grave Fermere - RrGF pranë FFRM-së. Diskutues të ftuar dhe ligjërues në punëtorinë ishin: Ljupčo Toshev nga Fondacioni Agrocentar, Gabriella Mitrikeska Micevska nga IME, Valentina Kolar – Jovanovska nga Balkan Biosert dhe Ivan Stojanov. Evenimenti filloi me takim të shkurtër të grave fermere, në të cilin ato i koordinuan aktivitetet e RrGF, ndërsa pas hyrjes në prodhimin organik u diskutua më konkretisht në lidhje me çështjen “Pse të kaloj në prodhues organik?” etj. Me shembuj konkret u sqarua cilët janë faktorët të cilët ndikojnë mbi prodhimin organik dhe si planifikohet konvertimi nga prodhues konvencional në prodhues organik. Gratë fermere, nga vende të ndryshme të Maqedonisë, morën më shumë informata në lidhje me atë se cilat janë implikimet financiare nga prodhimi organik dhe cilat janë të gjitha përfitimet për ato si bujk. ●



U formua fokus grupi i kooperativës në Gorni Podlog

Pas prodhimit të glikosë nga karota, të prodhuar në mënyrë tradicionale pa kimi, fokus grupi në Mustafino, vazhdon me prodhimin e spinaqit, të cilin e shet në tregjet lokale. Në mënyrë të njëjtë FFRM në suazat e kooperativës në Gorni Podlog, formoi fokus grupin e grave me të cilat planifikohet të prodhohen jufka për shitje në tregun vendas. Qëllimi i këtij fokus grupi është të rrisë anëtarësinë e kooperativës dhe të mundësojë shitjen e produkteve tona tradicionale nëpërmjet paraqitjes së bashkuar dhe të organizuar dhe motivimin e grave të mjediseve rurale për përfshirjen e tyre aktive në shoqata dhe kooperativa, si dhe nxitjen e fuqizimit të tyre ekonomik. Aktiviteti është pjesë e projektit “Mbështetje institucionale e FFRM”, e mbështetur nga We Effect ●



U publikua udhëzues praktik dhe masa për sanimin e tokave në rajonet e përmbytura



Federata e Fermerëve të RM-së, në bashkëpunim me Fakultetin për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim në Shkup dhe Fakultetin e Pylltarisë në Shkup, përpiluan Udhëzues praktik dhe masa për sanimin e tokave në rajonet e përmbytura, me të cilin në mënyrë të thjeshtë dhe praktike theksohen problemet me të cilat përballen fermerët, çfarë ata duhet të bëjnë gjatë fatkeqësive të këtilla elementare dhe çfarë nuk duhet të bëjnë. Udhëzues i një lloji të këtyre, për herë të

parë është publikuar si literaturë në RM dhe gjithashtu do të kishte pasur edhe aplikim rajonal, sepse është për katastrofa, të cilat shpesh paraqiten në Ballkan. Përmbajtja e Udhëzuesit është përpiluar nga profesorë të Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit, Shkup, Fakulteti i Pyjeve – Shkup pranë UKM dhe është pjesë e Projektit “Mbështetje institucionale e FFRM”, e mbështetur nga We Effect, Autorë të publikimit janë: prof. dr. Tatjana Mitkova, docent dr. Mile Markoski, prof. dr. Ivan Blinkov, prof. dr. Dragi Dimitrievski.

“Katastrofat nuk zgjedhin vend dhe kohë kur do të paraqiten, është vetëm çështje e probabilitetit. Diku ka probabilitet më të madh dhe diku më të vogël për paraqitjen e dukurisë së njëjtë. Prandaj, të gjitha vendet në botë, pa marrë parasysh zhvillimin e sistemit për alarmim të hershëm, janë të vetëdijshme për paraqitjen e rrezikut nga katastrofa të cilat mund t’i cenojnë interesat themelore nacionale të sigurisë.

Një nga katastrofat natyrore me të cilat u kapluan gjatë tre-katër viteve të kaluara (2013, 2014, 2015 dhe 2016) disa pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë, janë vërshimet dhe rrjedhat e rrëmbyeshme të formuara gjatë paraqitjes së stuhive të mëdha gjatë së cilave për kohë të shkurtë ka sasi të mëdha të reshjeve, të shoqëruara me erë të fuqishme. Më shumë pasoja nga kjo dukuri u manifestuan në (rajonin e Tetovës, Shkupit, Strumicës dhe Pellagonisë). Është e ditur se jetojmë në kohë të ndryshimeve klimatike. Kudo nëpër botë përpilohen modele të ndryshme për parashikimin e elementëve klimatik dhe të gjitha sugjerojnë se jetojmë në kohë të paraqitjes së dukurive gjithnjë e më ekstreme klimatike. Në këtë tekst theksi kryesor është vënë te vërshimet dhe rrjedhat e rrëmbyeshme të cilat u paraqitën në rajonet e lartpërmendura me qëllim të ndërmerren masa preventive për reduktimin e pasojave nëse përsëritet e njëjta. Vlerësimet e dëmeve nga vërshimet tregojnë se ato janë edhe më të larta nga shpenzimet për realizimin e masave preventive. Edhe gjatë këtyre vërshimeve, u tregua se masat e lira për mbrojtje nga vërshimet konsistojnë në rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe përrenjve, ndërtimin e argjinaturave, pyllëzimin etj. Problemi qëndron në faktin se për parandalim, zakonisht nuk ka para në buxhet, ndërsa më vonë duhet të gjenden para për sanimin e dëmeve”, thuhet në pjesën hyrëse të publikimit. •

Vizitë studimore e anëtarëve të Klubit të Prodhimit të Integruar të Mollës në Spille

Prodhimi dhe zhvillimi i biznesit dhe sidomos rritja e ndërgjegjësimit të fermerëve drejt arritjes së standarteve të Bashkimit European është një nga komponentët kryesorë të projektit “Zhvillimi i Komunitetit Rural nëpërmjet Shoqatave të Fermerëve” të cilin AgriNet Albania është duke e implementuar me mbështetjen e WeEffect, Suedi, në rajonet Korçë, Elbasan dhe Dibër.

Shkruan: Nikolin Karapanci

Në këtë kuadër u zhvillua një vizitë për shkëmbim eksperience në një nga zonat më të njohura të prodhimit të fidanëve të mollës në Spille të rajonit të Kavajës me anëtarë të Klubit të Prodhimit të Integruar të Mollës kryesisht nga rajini i Korçës dhe Dibër.

Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte njohja me teknologjinë e prodhimit të fidanëve të mollës me nënshartesë M9 e përdorur gjërësisht në kultivimin intensiv si dhe gjithashtu në teknologjinë e Prodhimit të Integruar në Mollë.





Grupi i vizitorëve i përbërë prej 29 fermerësh u prit në një nga fidanishtet më të njohura të zonës nga specialisti i fushës së prodhimit të fidanëve, por dhe i kultivimit të frutave z. Spiro Bllama si dhe disa prodhues të tjerë fidanash të po kësaj zone. Zoti Spiro prezantoi para vizitoreve të gjithë historikun e krijimit dhe zhvillimit të këtyre fidanishteve në këtë zonë duke theksuar faktin e afërsisë me eksperiencën Italiane në këtë drejtim.



Gjithashtu ai beri një pasqyrë të plotë të:

- Teknologjisë që zbatohet në prodhimin e fidanave të varieteteve bashkëkohor të mollës;
- Çertifikimit të fidanave në bazë të standarteve;
- Shtimit dhe prodhimit të nënshartesave bazuar në varietet e mollës;
- Shitjes së fidanëve në moshë dyvjeçare brenda dhe jashtë vëndit.

Në shoqërimin e specialistit u realizuan vizita në terren në disa parcela të fidanishtes por edhe në një pemtore disa vjeçare që shërben si parcelë demonstrimi, në të cilën dallohej shumëllojshmëria dhe cilësia e fidanave të mollës.

Me pyetje dhe diskutime rreth teknologjisë dhe avantazheve të mbjelljes së këtyre lloj fidanave, realizohet rritja e numurit të bimëve në sipërfaqe të vogla toke. Tek vizitorët u krijuan përshtypje pozitive rreth kësaj teknologjie bashkëkohore e cila lehtëson ndjeshëm punën në fermë duke i çuar të gjitha proceset drejt mekanizimit dhe njëkohësisht shtimin e sasisë dhe cilësisë së prodhimit. ●



Rrethet e Studimit, metodë e suksesshme për edukimin e fermerëve


Nga eksperiencia e Fondacionit AgriNet Albania

Shkruan: Eljona Meleg

Rrethet e Studimit si një metodë të mësuar për të rritur ka pasur një ecuri të kënaqshme për vitin 2016. Kjo metodë e pa njohur më parë nga fermerët u është bërë e njohur fermerëve nga Fondacioni AgriNet nëpërmjet implementimit të projektit "Zhvillimi i zonave rurale nëpërmjet fuqizimit të shoqatave të fermerëve" mbështetur nga We Effect.

Për këtë vit numërohen 14 Rrethe Studimi të ngritura në tre rajonet ku implementohet projekti në atë të Korçës, Elbasanit dhe Dibrës.

Tematikat që trajtojnë janë të shumëllojshme nga ruajtja e traditës në gatimet tradicionale dhe punimet e dorës, tema ekonomike mbi mar-



ketingun dhe buxhetin e fermës por edhe tematike me pikëpamje teknike si mbarështrimin e gjelave të detit por dhe kultivimi dhe ruajtja e bimëve aromatike dhe medicinale etj. Ashtu si tematikat janë të larmishme dhe grupmoshat që marrin pjesë janë gjithashtu të larmishme.

Në këto 14 Rrethe Studimi ka një përfshirje të lartë të grave, 7 Rrethe Studimi janë vetëm me gra, 5 janë mix burra dhe gra dhe dy janë vetëm me burra. Në total janë përfshirë 160 persona dhe nga këta 106 janë gra.

Zbatimi i kësaj metode ka bërë të mundur afrimin e njerëzve me njëri – tjetrin (bringing people together) për të diskutuar rreth një problem apo dhe një çështje të caktuar, për të përfituar nga eksperiencat dhe njohuritë e njëri-tjetrit, si në aspektin social ashtu dhe në atë ekonomik. Po ashtu kjo metodë ka sjellë ndryshimin e mentalitetit të anëtarëve në drejtim të bashkëpunimit.

Për në të ardhmen është planifikuar që të rritet numri i Rretheve të Studimit, pjesmarrja dhe zgjedhja e tematikave që lidhet me problemet aktuale të zonave rurale. ●





Prezantohet studimi “Mbi zhvillimin e zinxhirit të vlerës së turizmit në zonën e Pukës”

Shkruan Dr. Vitor Malutaj.

Më datën 21 dhjetor 2016, në ambientet e Hotel Turizmit Pukë, u prezantua studimi mbi zhvillimin e zinxhirit të vlerës së turizmit në zonën e Pukës. Të pranishëm ishin përfaqësues të bashkive Pukë e Fushë-Arrëz, drejtues e punonjës të hoteleve, haneve dhe pikave turistike që zhvillojnë veprimtarinë në këtë zonë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile të interesuar.

Fjalën e hapjes e mbajti Drejtori Ekzekutiv i AP-së, z. Sabah Djaloshi, i cili pasi ua uroi mirëseardhjen të pranishme bëri një prezantim të shkurtër të punës së bërë nga AP në kuadër të projektit “Të kontribuojmë në përmirësimin e qëndrueshëm të kushteve të jetesës në zonat rurale të rrethit të Pukës” financuar nga We effect-Swedish Cooperative Centre

Në fjalën përshëndetëse, Nënkrjetari i Bashkisë Pukë z. Artan Zaja u ndal në bashkëpunimin e shkëlqyer midis AP dhe pushtetit lokal. Ai theksoi se “ne e shohim si partner dhe promotor të zhvillimit rural dhe ekonomik AgroPukën. Së bashku edhe me aktorë e faktorë të tjerë synojmë të vëmë në funksion akoma më shumë tokat bujqësore duke prodhuar produkte BIO e në këtë mënyrë të pu-

nësohen edhe njerëzit dhe të fitojnë para. Si bashki kemi si synim që me politikat tona afatmesme dhe afatgjata të bëjmë realitet zhvillimin e turizmit malor, nëpërmjet politikave nxitëse fiskale për biznesin vendas dhe të huaj. Për sa i përket detyrave që na takojnë si sinjalistika, promovimi në media, guida, sistemi i adresave etj, po bëjmë më të mirën e mundshme.

Nënkrjetari i Bashkisë Fushë-Arrëz z. Ndue Doda vlerësoi punën e bërë në vazhdimësi nga APja në mbështetje të fermerëve edhe në bashkinë që ai drejton. Vlerësim shumë pozitiv bëri për studimin e realizuar. Zoti Doda theksoi faktin se popullsia e rrethit të Pukës është përgjysmuar në krahasim me vitet 90’ si rezultat i emigrimit dhe zhvendosjes së popullsisë në zonat fushore të vendit. Zhvillimi i turizmit theksoi ai, është një rrugë efikase për ta frenuar këtë fenomen, duke krijuar mundësi për punësim, rritjen e te ardhurave dhe përmirësimin e jetesës së banorëve të kësaj zone.


Në vazhdim, zoti Doda u ndal në përmirësimin dhe shkurtimin e rrugës që lidh dy bashkitë, duke anashkaluar kalimin e saj nga lartësitë mbi 900 m mbi nivelin e detit ku është sot, në një zonë më të ultë, rreth 700 m mbi nivelin e detit, duke shkurtuar edhe distancën me mbi 5 km.



→ Pas përshëndetjeve nga përfaqësuesit e pushtetit lokal, fjalën e mori z. Shkëlzen Marku- Doktor i Shkencave Ekonomike dhe një nga autorët e studimit. Ai bëri një prezantim të detajuar të studimit, që u ndoq me shumë interes nga të pranishmit.

Në diskutimin e tij z. Përparim Laçi-pronar i Hanit të Laçajve u shpreh se është hera e parë që flitet me shifra konkrete dhe reale për turizmin në rrethin e Pukës. Zhvillimi i turizmit duhet parë si një i tërë për të gjithë rrethin e Pukës dhe jo i ndarë në pjesë sipas përkatësisë në pushtetin vendor - u shpreh ai- pasi kështu bëhet një zhvillim funksional dhe i qëndrueshëm. Vetëm bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve dhe faktorëve të zhvillimit të turizmit mund të sjellë sukses theksoi zoti Laçi.

Kryetari i Shoqatës së Ekoturizmit z. Gjovalin Alia tha se ky studim është një diagnostikë aktuale e gjendjes së turizmit në rrethin e Pukës. Ai falënderoi AP për punën e bërë në vazhdimësi për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të kësaj zone, duke e vënë theksin në produktet specifike që prodhon AP, duke e bërë më të njohur dhe më atraktive këtë zonë.



Diskutues të tjerë si Astrit Kuçi-Nënkryetar i Bashkisë Pukë, Riza Tafilaku –studiues dhe autor i disa teksteve në fushën e turizmit dhe kulturës, Marije Shkja – kryetare e Grupit të Grave Qerret, Jetmir Qafa - pronar restoranti tradicional në Fushë-Arrëz, Tom Preku bashkautor i studimit etj, ngritën shqetësime, probleme dhe dhanë mendime të tilla si :

- a)** duhet punuar më shumë për turizmin historik, turizmin kulturor, turizmin kurativ etj, për të cilat Puka ka resurse, por duhen evidencuar, bërë të njohura për komunitetin dhe promovuar në të gjitha kanalet e mundshme informative, për t'u përdorur nga turistët vendas dhe të huaj.
- b)** U propozua që ky studim të vihet në dispozicion të të gjithë aktorëve të zhvillimit të turizmit në rrethin e Pukës dhe më gjerë.
- c)** u propozua të ngrihet një komitet i përbashkët i turizmit mes dy bashkive, i cili të punojë për përcaktimin e prioriteteve, mbi bazën e të cilave të hartohet edhe plani i veprimit konkret për vitin 2017 dhe perspektiven e zhvillimit në vitet e ardhshme. ●



Bashkëpunimi i IKC-së me qeveritë Lokale

Shkruan: Ardiana Lecaj dhe Ilir Gashi

Ndër prioritete e veprimit të IKC është edhe forcimi i kapaciteteve të qeverive lokale në komunat ku ajo vepron. Sigurisht se kjo objektivë e IKC-së nuk mund të arrihet pa pasur marrëdhënie të mira bashkëpunim me këto autoritete. Si rezultat saj IKC ka zhvilluar një sërë projektesh të përbashkëta pothuajse me të gjitha komunat ku ajo vepron. Mu për këtë, para disa kohe apo më saktësisht me datën 04.10.2016 është bërë nënshkrimi i marrëveshjes dyvjeçare për bashkëpunim në mes të komunës së Shtimes përkatësisht Drejtorisë së

Zhvillimit Ekonomik përfaqësuar nga z. Sabri Qerkini – drejtor dhe organizatës Initiative for Kosova Community (IKC). Ky projekt i financuar nga të dy palët, në mes të tjerash parasheh edhe: shpërndarjen e materialit fidanor të mjedrës, sistemin e ujitjes pika-pikë dhe rezervuar të ujitjes për 23fermerë, vizita studimore jashtë vendit si dhe ngritjen e kapaciteteve të fermerëve nëpërmes trajnimeve në fusha të ndryshme. Krahas kësaj me këtë marrëveshje parashihet edhe promovimi i produkteve të fermerëve të komunës së Shtimes, promovim ky që do të bëhet nëpërmes organizimit të panaireve të produkteve bujqësore.



Paraprakisht, siç parashihet me marrëveshje, organizata IKC për këta fermerë ka organizuar trajnime rreth mënyrës së përgatitjes së tokës, mbjelljes dhe kultivimit, për ushqim dhe ujitje të drejtë për kulturën e mjedrës si dhe mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit e mundshëm.

Organizata IKC duke parë interesimin e madh të fermerëve për të kultivuar këtë kulturë, në vazhdimësi po përkrah ata me fidane, trajnime, panaire, vizita studimore, etj. IKC do të merret edhe me gjetjen e tregjeve për prodhuesit e mjedrës si përfitues kryesor të kësaj marrëveshje.

Ne besojmë që një shoqëri e fortë dhe aktive do t'i realizoj zhvillimet dhe ndryshimet që i nevojiten Kosovës. Ne përpiqemi që të arrijmë një zhvillim të shoqërisë civile nëpërmjet aktiviteteve të programit por gjithashtu duke e zgjeruar mbështetjen tonë ndaj komunitetit

Pra, qëllimi ynë është, të arrijmë një shoqëri të zhvilluar rurale dhe të rrisim mirëqenien e popullsisë në bashkëpunim të ngushtë me qeveritë lokale dhe ato qendrore të Republikës së Kosovës. ●



Konferenca rajonale bujqësore me moderatorë mbi problemet bujqësore për 2016

Sektori bujqësor ka potencial të madh të zhvillohet edhe më tepër, por për shkak të problemeve të ndryshme ka ndalesë në zhvillimin e mëtejshëm



Shkruan: Mimoza Istrefi

Kosova si shteti më i ri në Ballkanin Qendror ka një GDP prej 14% të sektorit të bujqësisë dhe ky sektor është burimi kryesor i të hyrave në zonat rurale të Kosovës. Sektori i bujqësisë ka shumë potencial të zhvillohet dhe më shumë por për shkak të problemeve të ndryshme ka ngecje në zhvillim të mëtutjeshëm. Madhësia e fermave (me një mesatare prej 1,5ha), mungesa e teknologjive të reja, dhe produktiviteti në shkallë të vogël janë disa nga faktorët që ky sektor ka ngecje.

IKC për më shumë se 11 vite implemeton projekte në zhvillim të bujqësisë dhe gjithmonë bashkëpunon direkt me fermer dhe shoqata të ndryshme. Duke pas parasysh nevojat e fermerëve IKC ka organizuar konferencën rajonale bujqësore me panelist të fushave përkatëse, e cila ka trajtuar tema rreth problemeve bujqësore të vitit që po e lëmi, 2016. Kjo është konferenca e 3 qe organizohet radhazi ne 3 vitet e fundit. Qëllimi i konferencës ishte diskutimi problemeve bujqësore dhe informimi i fermerëve për mundësinë e zgjidhjeve të problemeve të tyre nga organet përgjegjëse. Te ftuar ne këtë konferencë ishin fermerët nga shumica e komunave të Kosovës, zyrtar komunal nga departamentet bujqësore, përfaqësues të organizatave të cilët janë të orientuar në zhvillimin e bujqësisë, përfaqësues të MBPZHR-s, AUV-it, si dhe nga Universiteti i Prishtinës dega e bujqësisë, agrobiznese, dhe furnitor të ndryshëm të imputeve bujqësore. Temat të cilat u diskutuan ne konferencë kanë ardh si rezultat i kërkesave të fermerëve gjatë punës së IKC-s ne teren. Konferenca u mbajti ne hotel Emerald dhe kishte një pjesëmarrje masovike te fermerëve; afro 120 fermer nga sektor te ndryshëm.

Panelist te kësaj konference ishin ekspert eminent nga fakulteti i Bujqësisë, MBPZHR, si dhe nga AUV. Temat e diskutuara ishin me sa vijon

- Prodhimtaria organike; u diskutua nga Prof. Mentor Thaçi
- Sëmundja gungore (LSD); u diskutua nga drejtori i departamentit të shëndetit të kafshëve nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë z. Bafti Murati
- Rëndësia e kultivimit të varieteteve të reja; u prezantua nga Prof. Vahid Avdiu
- Kapacitetet e ruajtjes dhe funksionalizimi i pikave grumbulluese; u prezantua nga Prof. Ekrem Gjokaj
- Njoftimi mbi punën e shërbimeve këshillimore: u diskutua nga Shef i divizionit për informim, bashkëpunim, monitorim dhe trajnim MBPZHR z. Tahir Halitaj.

Këto tema u shtjelluan nga ana e panelistëve dhe pas përfundimit të prezantimeve pyetje të shumëta u drejtuan nga ana e fermerëve rreth këtyre temave. Disa nga pytjet të cilat u parashtruan ishin:

- Sa është humbja nga involvimi në bujqësi organike?
- Për sa kohë është bërë parandalimi i sëmundjes gungore?
- Si po funksionojnë pikat grumbulluese?
- Çfarë do të bëjë ministria për fermerët e vegjël sidomos për ato femra?
- Sa janë të involvuar shoqatat në Ministri të Bujqësisë?

KONKLUZION:

Në fund të takimit erdhëm në përfundim se Kosova ka potencial të madh për zhvillimit të bujqësisë, por me shumë probleme. Kosova ka mundësi të zhvilloj bujqësinë organike dhe disa nga produktet organike të cilat kanë më shumë përparësi në Kosovë janë: prodhimi i mjaltës, bimët mjekësore dhe aromatike, pemët organike si dhe mishi dhe qumështi organik. Në kuadër të pyetjes për bujqësi organike prof. Mentor Thaçi

tha se në Kosovë më të sigurta dhe më të vlefshme do të ishin produktet organike sesa ato konvencionale sepse produktet organike mund të mbillen në shumta të vogla por të shiten me çmime më të larta dhe në këtë mënyrë involvimi me bujqësi organike është më profitabil.

Për sëmundjen gungore z. Bafti Murati tha se raporti nga shtetet në rajon për këtë sëmundje ka ardhur në kohë në Kosovë mirëpo mungesa e mjeteve për parandalim e bëri që kjo sëmundje të përhapet më shpejtë. Mungesa e fondit të veçantë nga ministria e financave për raste alarmante ishte gjithashtu ishte një faktor tjetër që ndikoni shumë në parandalim sa më të shpejt. Vlen të përmendet se qysh nga gjedhja e pare e sëmure lajmëruar ne Kosovë (ne qershor te vitit 2016, ne Junik) e deri ne pjesën e pare te nëntorit, janë atakuar 649 ferma dhe numri i kafshëve te ngordhura është 1,301. Gjithashtu duhet përmendur se vlera e një vaksine është 2 euro.

Ekonomia e një vendi shihet nga aftësia e atij vendi për ti shitur produktet e tyre tha Prof. Ekrem Gjokaj dhe më pas shpjegoi më shumë për pikat grumbulluese. Fermerët duhen të sigurojnë numrin e duhur të produkteve në mënyrë që pikat grumbulluese të sigurojnë çmimin për fermer. Prof. Ekrem Gjokaj gjithashtu shtoi se fermerët duhen të fokusohen më shumë në hulumtimin e tregut si dhe të konsultohen me OJQ dhe shërbimet këshillimore në mënyrë që të dëgjohet më shumë zëri i fermerëve. Më pas u bë e ditur se ministria momentalisht ka vetëm dy thirrje në vit për shoqata mirëpo ata shpresojnë që kjo situatë do të përmirësohet shumë shpejtë.

Tahir Halitaj përmendi te arriturat e departamentit të shërbimeve këshillimore pranë MBPZHR ku mes te tjerash tha se gjate vitit 2016 janë certifikuar gjithsej 136 këshilltar bujqësor ku prej tyre 39 janë te sektorit publik ndërsa 97 janë privat dhe ne total nga këto dy grupe te certifikuara 25 këshilltar ishin femra. Konferenca përfundoi me një drekë të tipit tavolinë suedeze. ●



FFRM



FFRM-ja i organizon dhe bashkon fermerët në nivel nacional, me qëllim të përbashkët që të zgjidhen problemet dhe të përmirësohet prodhimtaria në bujqësi dhe zhvillimi rural në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi kryesor është të jetë organizatë moderne, transparente dhe demokratike e fermerëve e cila është e njohur në nivel nacional dhe i njeh dhe bashkon pjesën më të madhe të bujqve, i përfaqëson dhe i mbron interesat e tyre dhe vepron në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të prodhimit bujqësor dhe rajonet rurale në përputhje me nevojat reale të bujqve në Republikën e Maqedonisë. FFRM-ja vepron në nivel nacional, në përputhje me nevojat dhe nevojat e anëtarëve të vetë. Si model i strukturuar hapëron sipas gjurmëve të bujqve suedeze me nënshkrim të marrëveshjes për bashkëpunim me Federatën Suedeze të Fermerëve. Mbi 10.000 njerëz janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte të përfshira në organizatë, domethënë: si anëtarë të organeve të menaxhimit, të punësuarit, vullnetarët, pjesëmarrësit në trajnime për punëtori edukuese, pjesëmarrësit në udhëtimet studimore jashtë shtetit,

në organizimin e panairëve dhe shumë formave të tjera. Përveç kësaj, realizohet bashkëpunim intensiv me organizata nga rajoni, siç janë Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Rumania, Sllovenia si dhe me organizata nga shtetet evropiane siç janë Suedia, Franca dhe Holanda. Një prej mjeteve më efikase të FFRM-së për informim dhe edukim është revista e saj mujore "Toka ime" e cila është e vetmja revistë mujore në Republikën e Maqedonisë e cila jep komentet dhe mendimet e bujqve, ekspertëve dhe institucioneve relevante, raporte, këshilla edukuese dhe analiza. Në drejtim të zhvillimit të fermerëve të vegjël, bashkëpunimit rajonal dhe kooperativave, FFRM-ja filloi me realizimin e projektit "Zhvillimi institucional i FFRM-së" i cili realizohet në bashkëpunim me organizatën suedeze We Effect.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe padrejtësive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribujmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetës së banorëve të zonave rurale të Pukës" që financohet nga We Effect (Suedi).

Projekti është në fazën e dytë të tij (2014-2016; faza e parë u zbatua gjatë 2011-2013) dhe

synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes lokale.

Në tre vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha: (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit; (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale. Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY-IKC



IKC, Initiative for Kosovo Community është themeluar në vitin 2005 si një prej organizatave lokale joqeveritare në Kosovë. Ajo është formuar si spin-off organizatë e organizatës joqeveritare belgjiane Balkanactie vzw. Ajo është themeluar nga personeli lokal i Balkantie vzw. Duke ditur se Kosova vuan nga shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë, përjashtim të grave nga aktivitetet socioekonomike, ne i drejtuam resurset tona kah zhvillimit socioekonomik të Kosovës. Momentalisht IKC-ja po zbaton dy projekte, një të financuar nga Kooperativa Suedeze We EFFECT, kurse tjetri i financuar nga Ambasada Britanike. Të dy projektet kanë për qëllim zhvillimin e shoqërisë rurale të Kosovës nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të biznesit. Për

faktiv se IKC-ja i përfshin të gjitha grupet etnike, gjinitë dhe sidomos bashkësitë e marginalizuara, IKC-ja punon në 10 komuna ku për nevojat për punësim janë më tepër se kruciale: Ferizaj, Shtime, Lipjan, Viti, Klllokot, Stërpçe, Partesh, Han i Elezit, Kaçanik dhe Gjakova. Deri më tani IKC-ja ka organizuar mbi 700 bujq në organizata të grave (WOs) dhe në organizata bujqësore (FOS). Midis tyre, më tepër se 50% janë WOs, kështu që gratë përforcohen ekonomikisht, politikisht dhe në anën sociale.

FONDACIONI AGRINET ALBANIA



AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë. AgriNet siguron shërbime të zgjeruara në pjesën më të madhe

të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë. Lloji kryesor i grupeve bujqësore për shërbime të zgjeruara

janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.